



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR.21/2023¹
PËR PROCEDURËN PËR PUNËSIMIN, PEZULLIMIN DHE LIRIMIN E
TË DËNUARVE NGA PUNA, SI DHE SHPËRBLIMIN PËR PUNËN E TË
DËNUARVE

¹ Udhëzim Administrativ MD - Nr. 21/2023 për procedurën për punësimin, pezullimin dhe lirim të të dënuarve nga puna, si dhe shpërblimin për punën e të dënuarve, i nënshkruar nga Ministrja e Drejtësisë më datë 29.12.2023

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 69 (paragrafi 6), neni 73 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR.21/2023 PËR PROCEDURËN PËR PUNËSIMIN, PEZULLIMIN DHE LIRIMIN E TË DËNUARVE NGA PUNA, SI DHE SHPËRBLIMIN PËR PUNËN E TË DËNUARVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurës për punësimin, pezullimin dhe lirimin e të dënuarve nga puna, si dhe shpërblimin për punën e kryer nga të dënuarit.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen në Institucionet Korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 3 Përkufizimi

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. **Punë** - nënkupton punën e të dënuarit apo të paraburgosurit brenda ose jashtë Institucionit Korrektues në pronat e Shërbimit Korrektues;

1.2. **Hapësirat punuese** - nënkupton çdo hapësirë në pronat e Shërbimit Korrektues në të cilën mund të ofrohet punë për të dënuarit apo të paraburgosurit;

1.3. **Paneli për punën e të burgosurve**- nënkupton komisionin multiprofesional të Institucionit Korrektues;

1.4. **Zyrtari për punën e të burgosurve** – nënkupton zyrtarin përgjegjës lidhur me menaxhimin e procedurave për punën e të dënuarve;

1.5.**Punëdhënësi** - nënkupton institucion, organizatë ose kompani publike apo private që ofron punë për personat e dënuar;

1.6.**Marrëveshje** - nënkupton marrëveshjen mes punëdhënësit, Institucionit Korrektues dhe të dënuarit;

1.7.**Kontrata** - nënkupton kontratën e lidhur mes punëdhënësit dhe personit të dënuar për punë në Institucione Korrektuese.

Neni 4

Parimet për punën e personit të dënuar

1. Personi i dënuar në llojin e punës së dhënë nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose shoqërore, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual.
2. Institucioni Korrektues i ofron personit të dënuar zgjedhjen e punës, e cila është e aplikueshme dhe në pajtim me planin individual të dënimit dhe programin përkatës profesional.
3. Personit të dënuar për punën e kryer i takon shpërblimi mujor.

Neni 5

Qëllimi i punësimit

1. Personi i dënuar i aftë për punë ka të drejtë dhe obligim për të punuar.
2. Institucioni Korrektues për aq sa është e mundur siguron punë për personin e dënuar në hapësirat dhe objektet e Institucioneve Korrektuese ose pronat jashtë Institucionit Korrektues, si dhe në vendpunimet e kontraktuara me persona fizik ose kompani brenda Institucionit Korrektues.
3. Institucioni Korrektues nëse është e mundur duhet të siguroj punë për personin e dënuar duke marrë parasysh aftësitë dhe shkathtësitë fizike dhe mendore të tij.
4. Personave të dënuar u ofrohet punë që mund të ndikoj pozitivisht në ngritjen dhe zhvillimin e aftësive profesionale.
5. Puna për personin e dënuar duhet të jetë e dobishme, të ndikoj në riedukimin, risocializimin e tij dhe nuk duhet të jetë degraduese.
6. Puna e personit të dënuar duhet të konsiderohet si element pozitiv dhe në asnjë formë nuk mund të imponohet si dënim disiplinor.

Neni 6

Llojet e punës për të dënuarit

1. Të dënuarit mund të punojnë në Institucioneve Korrektuese ose në pronat jashtë Institucionit Korrektues në veprimtari punuese të cilat organizohen nga Njësia Ekonomike e Shërbimit

Korrektues të Kosovës (SHKK), si dhe veprimtarinë sipas kontraktimit me kompaninë ose personat fizik brenda Institucionit Korrektues.

2. Veprimtaritë punuese ku mund të angazhohen personat e dënuar përcaktohen si në vijim, por pa u kufizuar vetëm në:

- 2.1. mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të SHKK-së;
- 2.2. përpunimi i metaleve të ndryshme;
- 2.3. kuzhina;
- 2.4. agrokultura;
- 2.5. mirëmbajtja pajisjeve në institucionet korrektuese;
- 2.6. pastrimi i hapësirave në institucionet korrektuese;
- 2.7. lavandëri;
- 2.8. prodhimi dhe përpunimi i qeseve për mbeturina;
- 2.9. prodhimi dhe përpunimi i letrës së tualetit dhe letrës së kuzhinës;
- 2.10. prodhimi dhe përpunimi i drurit;
- 2.11. mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve në institucionet korrektuese;
- 2.12. floktaria;
- 2.13. rrobaqepësi;
- 2.14. përpunimi i produkteve të brumërave (bukë, kiflet, byrek, makaron);
- 2.15. angazhimi dhe mirëmbajtja e depove në institucionet korrektuese;
- 2.16. punë sipas kontratës me kompaninë ose personin fizik.

Neni 7 **Kategorizimi i punës për të dënuarit**

1. Puna për të dënuarit kategorizohet si në vijim:

- 1.1. punët profesionale;
- 1.2. punët teknike;
- 1.3. punët mbështetëse.

2. Për qëllime të këtij Udhëzimi, punë profesionale konsiderohen:

- 2.1. mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të SHKK-së;
- 2.2. përpunimi i metaleve të ndryshme;
- 2.3. prodhim dhe përpunim i drurit;
- 2.4. mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve në institucionet korrektuese;
- 2.5. rrobaqepësia;
- 2.6. prodhim dhe përpunim i qeseve për mbeturina;
- 2.7. prodhim dhe përpunim i letrës së tualetit dhe letrës së kuzhinës;
- 2.8. punë tjera që për nga natyra janë të përafërta.

3. Për qëllime të këtij Udhëzimi, punë teknike konsiderohen në:

- 3.1. kuzhinë;
- 3.2. agrokulturë;
- 3.3. lavandëri;
- 3.4. Floktari;
- 3.5. mirëmbajtjen e pajisjeve në institucionet korrektuese;
- 3.6. punët tjera që për nga natyra janë të përafërta;

4. Për qëllime të këtij Udhëzimi, punë mbështetëse konsiderohen:

- 4.1. pastrimi i hapësirave në Institucionet Korrektuese;
- 4.2. angazhimi dhe mirëmbajtja e depove në institucionet korrektuese;
- 4.3. punë të tjera që për nga natyra janë të përafërta.

Neni 8

Procedura për punësimin e të dënuarve

1. Zyrtari përgjegjës për punë i institucionit korrektues në bashkëpunim me udhëheqësin e Njesisë Ekonomike duhet t'i identifikojnë dhe përpilojnë listat e vendeve të punës në të cilat planifikojnë t'i punësojnë të dënuarit.

2. Lista e vendeve të punës mund të rishikohet, plotësohet dhe ndryshohet sipas nevojave të Institucionit Korrektues.
3. Zyrtari përgjegjës për punë është përgjegjës për të gjitha çështjet procedurale të punësimit të dënuarve, pezullimit dhe lirimit të tyre nga puna.
4. Zyrtari përgjegjës për punë i njofton të dënuarit me listën e vendeve të punës dhe procedurën e punësimit sa më parë që është e mundur.
5. Nëse është e pamundur t'i sigurohet punë personit të dënuar, i dënuari angazhohet në aktivitete tjera sipas nevojës së institucionit korrektues ose shqyrtohet mundësia e transferimit për të dënuarin në institucionin korrektues tjetër ku mund të zbatohet plani individual i dënimit.

Neni 9

Aplikimi i të dënuarit për punë

1. I dënuari mund të paraqes kërkesë për të punuar sipas listës së vendeve të punës dhe planit individual të dënimit.
2. Nëse zyrtari përgjegjës për punë pas pranimit të kërkesës nga i dënuari konstaton se nuk ka vende të lira për punë, duhet ta njoftoj të dënuarin, ndërsa nëse ka vende të lira kërkesën e procedon te Udhëheqësi i Panelit për Punë për shqyrtim brenda afatit prej pesë (5) dite pune.
3. I dënuari kërkesën për punësim e parashtron sipas formularit i cili është pjesë e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10

Përbërja e Panelit për punësim të dënuarve

1. Paneli për punësimin e të dënuarve themelohet me vendim të Drejtorit të Institucionit Korrektues i cili është kompetent për vlerësim dhe rekomandim.
2. Paneli për shqyrtimin e kërkesave përbëhet nga tre (3) anëtarë profesional të fushave përkatëse si:
 - 2.1. Zyrtar nga fusha e sigurisë;
 - 2.2. Zyrtar ligjor;
 - 2.3. Zyrtar të tjerë profesional.

Neni 11

Proceduara për shqyrtimin e kërkesave

1. Udhëheqësi i Panelit pas pranimit të kërkesës për punë nga të dënuarit i njofton anëtarët e panelit dhe cakton datën dhe kohën për shqyrtimin e kërkesave.

2. Paneli shqyrton kërkesat e pranuarat për punë nga të dënuarit dhe përgatit raportin me rekomandime për Drejtorin e Institucionit Korrektues në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, në të cilën rekomandohet punësimi për të dënuarin.

Neni 12 **Vendimmarrja**

1. Drejtori i Institucionit Korrektues pas shqyrtimit të rekomandimeve të Panelit, vendos për punësimin e të dënuarit.

2. Drejtori i Institucionit mund ta refuzoj kërkesën e të dënuarit për punë, dhe me këtë rast vendimi për refuzim duhet të arsyetohet me shkrim me të cilin njoftohet i dënuari.

3. Drejtori i Institucionit Korrektues në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i rekomandimit vendos për aprovim apo refuzimin e kërkesës për punë të dënuarit.

4. Të dënuarit të cilët janë në pavijon të tipit të mbyllur apo në burgun e sigurisë së lartë mund të angazhohen në punë sipas rrethanave të përshtatshme.

5. Nëse personit të dënuar i jepet leja për të punuar në kompani apo të personat fizik në impiantet brenda institucionit korrektues, i dënuari lidh kontratë për punësim me kompaninë apo personin fizik përkatës.

6. Kundër vendimit të Drejtorit të Institucionit Korrektues për lejimin apo refuzimin për punë, i dënuari mund të parashtrijë ankesë te Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 13 **Leja për punën e të dënuarit**

1. Leja e punës e cila i lëshohet të dënuarit duhet të përmbajë të dhënat personale dhe të nevojshme për të dënuarin.

2. Leja për punë duhet të bëhet në formë të shkruar, të cilën i dënuari është i obliguar ta mbajë gjatë angazhimit në punë dhe një kopje të vendoset në dosjen personale.

Neni 14 **Orari i punës**

1. Personi i dënuar i cili angazhohet në punë, punon dyzet (40) orë në javë, por orari i punës mund të jetë më i gjatë sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Personi i dënuar që vijon shkollimin e aftësimet profesionale si dhe programet rehabilituese, punon proporcionalisht më pak orë dhe konsiderohet se ka punuar me orar të plotë.

3. Personi i dënuar mund të urdhërohet të punojë jashtë orarit të punës deri në dy (2) orë në ditë për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe kryerjen e obligimeve të tjera të zakonshme në Institucionin Korrektues.
4. Personi i dënuar që ka punuar më tepër se gjashtë (6) muaj gjatë qëndrimit në Institucionin Korrektues ka të drejtë në pushim vjetor në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi të punës.
5. Personi i dënuar shpërblehet gjatë periudhës së pushimit vjetor sikurse të punonte.

Neni 15 **Mbrojtja dhe siguria në punë**

Mbrojtja e shëndetit të dënuarve në punë dhe ambiente të punës, me qëllim që të parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe sigurimi për të dënuarin që pëson paaftësi apo dëmtim të shkaktuar gjatë punës, bëhet sipas dispozitave të legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 16 **Monitorimi**

1. Monitorimin e punës së të dënuarve si dhe kushtet në vendin e punës e bënë zyrtari përgjegjës për punë ose zyrtari tjetër me autorizim të Drejtorit të Institucionit Korrektues.
2. Masat tjera të sigurisë në punë aplikohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 17 **Shpërblimi për punën e kryer dhe mënyra e realizimit**

1. Personi i dënuar ka të drejtë në shpërblim mujor për punën e tij.
2. Shpërblimi për punën e të dënuarve për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me orët dhe cilësinë e punës së kryer.
3. Shuma e shpërblimit mujor për punën e kryer nga personi i dënuar sipas nenit 7, paragrafi 1 të këtij Udhëzimi caktohet me vendim të Ministrit të Drejtësisë.
4. Shpërblimi për punën e kryer nga të dënuarit në kompani bëhet sipas kontratës së lidhur mes palëve.
5. Institucioni Korrektues mban regjistër të saktë për shpërblimin e pagës për punën e të dënuarit.
6. Transaksionet financiare lidhur me punën e të dënuarve rregullohen sipas dispozitave të akteve përkatëse në fuqi.

Neni 18

Disponimi me shpërblimin

1. Personi i dënuar mund të shpenzoj deri në shtatëdhjetë (70%) përqind të shpërblimit për punën e kryer, kurse pjesa e mbetur ruhet në xhirollogari të ruajtjes së parave.
2. Drejtori i Institucionit Korrektues mund të lejojë shpenzimin e mjeteve nga xhirollogaria e ruajtjes së parave të kursimit, nëse ato janë të domosdoshme për personin e dënuar ose familjen e tij.
3. Për zbatimin e paragrafit të 2 të këtij neni, nevojitet kërkesa e të dënuarit dhe autorizimi për transferimin e mjeteve nga xhirollogaria e tij në xhirollogarinë e familjarit, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 19

Pezullimi nga puna brenda Institucionit Korrektues

1. Personi i dënuar i cili është angazhuar në punë mund të pezullohet nga puna nëse:
 - 1.1. ndaj tij është iniciuar procedurë disiplinore;
 - 1.2. gjendja shëndetësore e tij e bënë të pa mundur vazhdimin e punës edhe pas pushimit mjekësor me pagesë;
 - 1.3. nëse rrezikohet siguria e institucionit, personave tjerë apo vet të dënuarit;
 - 1.4. shkaqe tjera të cilat do të ndikonin negativisht në vazhdimin e punës.
 - 1.5. vendimin për pezullimin nga puna e merr Drejtori i Institucionit Korrektues.

Neni 20

Lirimi nga puna brenda Institucionit Korrektues

1. Personi i dënuar i angazhuar në punë mund të lirohet nga puna pa u kufizuar:
 - 1.1. në përfundimin e dënimit;
 - 1.2. me vendim të punëdhënësit, i cili duhet të arsyetoj lirimin nga puna;
 - 1.3. rritjen e dukshme të rreziqeve të pakontrollueshme;
 - 1.4. me kërkesë të personit të dënuar, e cila vlerësohet e arsyeshme;
 - 1.5. paaftësisë së përhershme fizike apo mendore për punë;
 - 1.6. arritjen e moshës së pensionimit;

1.7.kur kanë pushuar nevojat e institucionit korrektues për atë vend të punës;

1.8.në raste të tjera të parapara me dispozita të përgjithshme të punës në Republikën e Kosovës.

2. I dënuari i cili lirohet nga puna për shkak të masës disiplinore për shkelje të rëndë nuk mund të angazhohet në punë në afat prej tre (3) muajsh, përjashtimisht punës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e objekteve në institucionin korrektues.

3. Procedura e punësimit sipas këtij Udhëzimi Administrativ zbatohet për çdo rast kur i dënuari paraqet kërkesë për punësim apo ripunësim.

4.Vendimin për lirimin nga puna e merr Drejtori i Institucionit Korrektues për të gjitha rastet e parapara në paragrafin 1, përjashtimisht nën paragrafit 1.1 pasi që nuk është e nevojshme të nxjerret vendim.

Neni 21 **Zbatimi përshtatshmërisht**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ lidhur me procedurat e punësimit, pezullimit dhe lirimit nga puna zbatohen përshtatshmërisht dhe aq sa është e lejuar sipas dispozitave ligjore në fuqi ndaj të paraburgosurve.

Neni 22 **Shfuqizimi**

Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi MD-NR.02-2015 për Organizimin e Punës dhe Shpërblimin mujor për punën e personit të dënuar.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

29/12/2023